

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

UJESJELLES-KANALIZIME SH.A- SARANDE

Sarande, me 24.04.2019

Për : Shoqerine “2 T” shpk

NIPT K01731001M

Procedura e prokurimit : Kerkese per propozim

Numri i references se procedures : **REF-11125-02-28-2019**

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“NDERTIMI I KAFAZIT TE SHKALLES ME VETRAT XHAMI TE TEMPERUAR”**

Fondi limit : **3.362.545 (tremilion treqind gjashtedhjetë e dymije e peseqind e dyzet e pese) lekë pa tvsh**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Publikime të mëparshme : **Buletini i Njoftimeve Publike nr. 9, date 4 Mars 2019**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. “2 T” shpk Nipt K01731001M	2 964 500 leke
2. “ILIRIA/D” shpk Nipt J66702510D	3 283 567 leke
3. “MANE/S” shpk Nipt J64103865K	3 306 240 leke
4. “NEAL-86” shpk Nipt K04644851T	3 061 910 leke
5. “SAVRIKAL” shpk Nipt J76705511E	3 045 775 leke

Operatorët “2 T” shpk, “Mane/S” shpk dhe “ILIRIA/D” shpk ne oferte, kane dorezuar te gjitha dokumentet sipas kerkesave te DST-se.

Ndersa operatorët “Savrikal” shpk dhe “NEAL-86” shpk, kishin mangesira ne permbushjen e kriterëve dhe kushteve te percaktuara ne DST, me konkretisht:

1. Operatoti “Savrikal” shpk

Kriteret e vecanta te kualifikimit.

Per Piken 2.2.1

Ne baze te nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”, dhe nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm*

nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.

Ne ofertën e tij ekonomike OE “Savrikali” sh.p.k. **“Punimet veshje xham i temperuar, Pergatitje konstruksione te thjeshta, Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem ”** zene mbi 70 % te puneve qe operatori ekonomik kerkon te realizoj, por sipas situacionit te kontrates te paraqitur per punet e ngjashme nga operatori ekonomik “Savrikali” sh.p.k. për këtë procedurë prokurimi rezulton se në kontratën e ngjashme të paraqitur, të mos jenë kryer te gjitha keto zëra punimesh, qoftë edhe në një vlerë minimale për të vërtetuar se ky operator ekonomik është i aftë dhe ka kapacitetet e duhura për të kryer punimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstaton se elementët e kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nuk gjejnë pasqyrim në situacionin përkatës të kontratave të dorëzuara nga operatori ekonomik për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

2. Operatoti “NEAL-86” shpk

Kriteret e vecanta te kualifikimit.

Per Piken 2.2.1

Ne baze te **nenit 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:** *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”, dhe nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... ”.*

Ne ofertën e tij ekonomike OE “NEAL-86” sh.p.k. **“ Punimet veshje xham i temperuar, Pergatitje konstruksione te thjeshta, Veshje fasade me xham struktural i pathyeshem ”** zene mbi 70 % te puneve qe operatori ekonomik kerkon te realizoj, por sipas situacionit te kontrates te paraqitur per punet e ngjashme nga operatori ekonomik “NEAL-86” sh.p.k. për këtë procedurë prokurimi rezulton se në kontratën e ngjashme të paraqitur, të mos jenë kryer te gjitha keto zëra punimesh, qoftë edhe në një vlerë minimale për të vërtetuar se ky operator ekonomik është i aftë dhe ka kapacitetet e duhura për të kryer punimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Situacioni perfundimtar i paraqitur nga ky operator permbane vetem zerin “Vetrat duralumin me mbushje d.a zyre” ne nje vlere minimale krahasuar me vleren e ketyre punimvete hartuara ne preventivin e AK.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave konstaton se elementët e kërkuar në preventivin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nuk gjejnë pasqyrim në situacioni përkatës të kontratave të dorëzuar nga operatori ekonomik për vërtetimin e eksperiencës së mëparshme.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Vlersimit te Ofertave vlerëson se kontrata e paraqitur nga

operatori ekonomik per procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet e vlefshme.

Per Piken 2.3.8

Per kete pike Operatori ekonomik ka sjelle te gjitha mjetet, pervec Kompresorit, pasi ne faturen e blerjes se ketij mjete kemi te shprehur Aparat Saldimi dhe Trapan Bosh, dhe jo kompresor te kerkuar ne DST-ne e hartuar nga AK.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerine “2 T” shpk, me NIPT NIPT K01731001M, me adresë: Tiranë,Rruga “Asim Vokshi”,Ndërtesa 14,Hyrja 25,Apartamenti 26, se oferta e paraqitur, me vlere : 2 964 500(dy milion nenteqind gjashtedhjetë e katermije e peseqind) lekë pa tvsh

është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ujesjelles Kanalizime sh.a Sarande* kopjen e sigurimit të kontratës, si dhe te paraqiteni per nenshkrimin e kontrates, sic parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) diteve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, sic parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë më datë **26.03.2019**

Ankesa : Me date 01.04.2019, ora 16.00 ka paraqitur ankese OE “NEAL-86” shpk.

Me date 05.04.2019, Komisioni i shqyrtimit te ankesave i ngritur per shqyrtimin e kesaj ankese, ka vendosur te leje ne fuqi vendimin e KVO per s.kualifikimin e OE “NEAL-86” shpk, vendim i cili i eshte komunikuar OE “NEAL-86” shpk, me shkresen nr. 147/1 date 08.04.2019.